



Datë: 26 Qershor 2024

TERMA REFERENCE

SHËRBIMI I KËRKUAR: EKSPERTIZË PËR REALIZIMIN E NJË RAPORTI MONITORIMI

1. HYRJE

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (QDGJSH) është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jo-politike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbron të drejtat e tyre dhe lufton pabarazitë gjinore. QDGJSH është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë më datë 28/06/2022 me vendimin nr. 1738. Sipas legjislacionit në fuqi, QDGJSH është regjistruar gjithashtu pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë me nr. NIPT: M22002451K.

Misioni i Qendrës është të kontribuojë për krijimin e një shoqërie ku të gjitha gratë të jetojnë një jetë me dinjitet, pa diskriminim dhe me mundësi të barabarta.

Qasja e Qendrës për Drejtësi Gjinore në Shqipëri, është:

- Të punojë për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, rritjen e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare rreth të drejtave të grave dhe çështjeve gjinore;
- Të mbështesë gratë dhe vajzat për të rritur pjesëmarrjen dhe influencën e tyre në jetën sociale, ekonomike dhe politike të vendit nëpërmjet zbatimit të programeve të lidershit, rritjes së aftësive profesionale, etj.;
- Të adresojë nevojat e grave dhe vajzave viktime të dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve direkte me qëllim fuqizimin e tyre social dhe ekonomik;
- Të rrisë kapacitetet e punonjësve të institucioneve shtetërore dhe jo-shtetërore që punojnë për mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për gra dhe vajza;
- Të advokojë dhe llobojë për respektimin e të drejtave të grave dhe arritjen e drejtësisë gjinore në shoqërinë shqiptare;
- Të kryejë studime, analiza dhe kërkime rreth çështjeve gjinore, përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.

2. INFORMACION MBI SHËRBIMIN E KËRKUAR

Qendra për Drejtësi Gjinore, më 1 Maj 2024, ka filluar zbatimin e projektit: “Monitorimi dhe përmirësimi i zbatimit të buxhetimit dhe politikave gjinore në Bashkinë Elbasan”, me mbështetjen nga skema e granteve “BAT Civil Society”, e zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në partneritet me Faktoje dhe Center for Research and Policy Making (CRPM), mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.

Në kuadër të projektit, **kërkohet të kontraktohet një ekspert për realizimin e një raporti monitorimi mbi zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në Bashkinë Elbasan.**

Monitorimi do të bazohet në 5 fusha prioritare:



- I. Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.
- II. Zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.
- III. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.
- IV. Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qendrueshëm.
- V. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

Krahas sa më sipër, do të analizohen edhe: burimet e nevojshme njerëzore, infrastrukurore, si dhe koordinimi i veprimeve dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore.

Raporti do të monitorojë edhe transparencën dhe llogaridhënien e Bashkisë jo vetëm kundrejt qytetarëve të saj, por edhe me institucione të tjera vendore, kombëtare e ndërkombëtare.

Qëllimi i hartimit të raportit të monitorimit do të jetë të ndikojë në përmirësimin e zbatimit të buxhetimit gjinor, politikave të barazisë gjinore dhe mbrojtjes sociale për gratë dhe vajzat në Bashkinë Elbasan.

PERIUDHA E SHËRBIMIT TË KËRKUAR

Shërbimi do të ofrohet gjatë periudhës 15 Gusht – 15 Tetor 2024 dhe do të konsistojë në 16 ditë pune.

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Të realizojë metodologjinë e raportit të monitorimit dhe të vijojë punën për hartimin e tij pas aprovimit të metodologjisë nga QDGJSH;
- Të hartojë draft-raportin;
- Të finalizojë raportin e monitorimit në përshtatje me komentet sugjerimet e QDGJSH mbi draftin (në rast se do të ketë);
- Të ketë komunikim korrekt dhe bashkëpunim me stafin e QDGJSH, përgjegjës për zbatimin e projektit;
- Të përgatisë dhe dorëzojë kohëshënuesin për punën e kryer në përfundim të shërbimit të kërkuar.

4. KUALIFIKIME DHE AFTËSI TË KERKUARA

- Diplomë universitare (preferohet në shkencë sociale apo drejtësi);
- Master shkencor apo profesional (preferohet në shkencë sociale apo drejtësi);
- Të zotërojë njohuri shumë të mira të çështjeve gjinore, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut;



- Të ketë eksperiencë të mëparshme pune për realizimin e studimeve, raporteve të monitorimit, manualeve, udhëzuesve me fokus në çështjet gjinore;
- Të ketë eksperiencë të mëparshme pune me organizata të shoqërisë civile;
- Të zotërojë aftësi shumë të mira komunikuese;
- Të jetë bashkëpunues/e, me qasje pozitive dhe etikë profesionale.

5. PROCESI I APLIKIMIT

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë me shkrim në adresën elektronike ose adresën postare të Qendrës për Drejtësi Gjinore dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Curriculum Vitae;
- Letër motivimi;
- Punime/publikime të mëparshme;
- Ofertë financiare për shërbimin e kërkuar.

Adresë elektronike: genderjusticealbania@gmail.com; adena.vangjeli@gjalbania.org

Adresë postare: Rr. "Nikolla Tupe", P. 352, Ap. 3, Tiranë, Shqipëri.

6. AFATET

Afati për dërgimin e aplikimeve: 26/07/2024, ora 17:00

Njoftimi i aplikantëve: 06/08/2024